



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 739/4 Prot.

Tiranë, më 1/8/2013

REKOMANDIM

Nr. 15 datë 01/08 2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr. 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit “Teleperformance Albania” (Albania Marketing Services sh.p.k) Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 121 datë 03/07/2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “Teleperformance Albania” (Albania Marketing Services sh.p.k) Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri dhe kontrolluesi u njoftua paraprakisht për ushtrimin e këtij kontrolli.

Objekti i kontrollit administrativ ishte:

Ligjshmëria dhe proporcionaliteti i përpunimit të të dhënave personale bazuar në qëllimin/qëllimet e përpunimit, në lidhje me:

- Respektimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale;
- Transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale dhe respektimin e detyrimeve ligjore në këtë fushë.

Grupi i kontrollit administrativ:

- U njoh dhe shqyrtoi dokumentacionin e kontrolluesit.
- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësues të kontrolluesit.
- Inspektoi ambientet e kontrolluesit.
- Administroi me cilësinë e provës në funksion të kontrollit administrativ:
 - “kontrate pune tip”.
 - “KONTRATË- PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA NJË SHOQERI E TRETË”.
 - “Rregullore e Brendshme e Teleperformance Albania (AMS Sh.p.K.)”.
 - “tabele me të dhënat që përdoren me klientët”.

Gjatë kontrollit administrativ janë krijuar kushte për ushtrimin e tij, përfaqësuesit e kontrolluesit u treguan bashkëpunues në të gjitha fazat e ushtrimit të kontrollit administrativ, si dhe vendosen në dispozicion të grupit të kontrollit të gjitha materialet dhe dokumentet shkresore të kërkuara.

Kontrolluesi "*Teleperformance Albania*" Tiranë mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale për kategorinë "*punonjës*". Të dhënat e punonjësve mblidhen për qëllim specifik të përcaktuar qartë për të lidhur një marrëdhënie punë mes kontrolluesit dhe punonjësit.

Kontrolluesi "*Albania Marketing Services*" sh.p.k për punonjësit e tij mbledh dhe përpunon të dhëna personale sensitive lidhur me gjendjen gjyqësore të tyre, punonjësit dorëzojnë pranë kontrolluesit "*dëshminë e penaltetit*" të tyre.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbledhjen e të dhënave personale lidhur me gjendjen gjyqësore për kategorinë "*punonjës*" e konsideron të tepërt dhe jo proporcionale. Mbledhja e kësaj të dhëne personale është e tepërt dhe e pa nevojshme pasi kontrolluesi për t'u bindur për garancinë dhe sigurinë e punonjësit mbledh të dhëna dhe informacione të tjera të mjaftueshme për realizimin e qëllimit të tij.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale kontrolluesi duhet të respektojë dhe të garantojë të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave personale (*punonjësit*) dhe veçanërisht të drejtën e ruajtjes së jetës private, të drejta të cilat janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për "*Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*" si dhe ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

1. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale sensitive mbi gjendjen gjyqësore të punonjësve me qëllim punësimin e tyre është e tepërt dhe jo proporcionale lidhur me qëllimin për të cilin ato mblidhen dhe përpunohen.
 - Në këtë rast është shkelur neni 5 pika 1/c e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar ku thuhet "...1. mbrojtja e të dhënave personale bazohet.....(c)...në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim"
2. Kontrolluesi "*Teleperformance Albania*" (*Albania Marketing Services* sh.p.k) nuk ka kryer detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
 - Në këtë rast është shkelur neni 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar ku thuhet "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë"

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar si dhe 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 5 pika 1/c të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar:

- Të ndalohet menjëherë mbledhja e të dhënave personale për gjendjen gjyqësore, për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale “punonjës”;
 - Të hiqen nga dosjet e punonjësve “Dëshmia e Penalitetit”, duke ja kthyer punonjësve.
2. Në zbatim të nenit 21, pika 1, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të plotësohet menjëherë “Formulari i Njoftimit”, duke njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale .
 3. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
 4. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, sipas të cilit... “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

